



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 39-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 14. 12. 2020, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Naim Stullca, anëtar
8. Majlinda Sylejmani, anëtare
9. Ramadush Tasholli, anëtar
10. Arif Miftari, anëtar
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Xhyzide Rrustemi, anëtare
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi, Hasani, anëtare
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Safete Amerllahu, anëtare
24. Bashkim Budakova, anëtar
25. Ukë Kryeziu, anëtar
26. Ganimete Qeriqi, anëtare
27. Manush Shamolli, anëtar
28. Egzona Fazliu, anëtare
29. Arben Salihu, anëtar
30. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Latif Ramadani DBF
3. Merita Bytyqi, DSH
4. Bekim Shabani DEZH

5. Emina Rexhiq DPU
6. Shefqet Amërlahu,DB
7. Avni Olluri,DA
8. Dhe të tjerë prezent

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi,pasi që i përshëndeti të pranishmit tha uroj që jeni mirë ju dhe familjet tuaja. Pastaj tha se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit. Rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 39-të të Kuvendit
2. Popozim vendim për miratimin e Planit të Integritetit 2021-2022
3. Prezantimi i Raportit të Punës të Sektorit për Personel Janar-Nëntor 2020
4. Propozim vendimi për shpalljen e lokalitetit të Boshtres(Forsythia Europea) Golesh si zonë e mbrojtur.
5. Propozim vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës.
6. Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.
7. Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.
8. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare.
9. Propozim vendim për miratimin e Planit Orientues të Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2021.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Lumturije Bytyqi-Hasani, ne si grup i PDK-s konsiderojmë se duhet të shtohet edhe një pikë shtesë siç është, Propozim vendim për t'i ndihmuar familjet e prekura me Covid-19 dhe familjarët e personave që kanë humbur jetën nga pandemia covid-19. Kërkoj nga ana e anëtarëve të kuvendit ta përkrahin këtë propozim.

Imri Ahmeti,sot është mbyllja e të gjitha kategorive të zotimeve,jemi në periudhën që nuk mund të bëjmë më zotime.Nuk është mirë që me e shfrytëzu pandeminë covid-19 për poena politik.Unë jam për me kalu ky propozim por vetëm bënë 3 anëtarë të komisionit nga kuvedi dhe ejani e gjeni mjetet unë jam i gatshëm me ju ndihmu edhe atë jo aq mjetet sa ju propozuat por edhe më shumë,por nuk kemi mjete. Ne i kemi pas dy herë pakon emergjente në Kuvend prap tash janë edhe 800 pako ushqimore dhe po e them publikisht kushdo që ka nevojë për ndihmë le të kontaktoj me shtabin emergjent dhe do të jenë përfitues.Prap unë po e përsërisë se jam i gatshem me ju ndihmu, por për këtë vit nuk kemi mjete.

Lulzim Rustemi,na tani kemi një gjendje pak më ndryshe se që e kishim në fillim të pandemisë pasi që tani ka një rrezik tjetër ka një rritje të madhe të njerëzve.A ka buxhet a jo e din më së miri ekzekutivi,por propozimet vijnë edhe prej anëtarëve të kuvendit.Lumja e ka pas pas si propozim ma herët dhe ne si grup e kemi përkrahë.Nëse ka subvencione dhe ka mundesi me u pagu është mirë me u bërë keto pagesa me u shiqu ky propozim.Vendimet a munden me u zbatu ajo e din me së miri ekzekutivi.Në bazë të njerëzve të ciliët i njohim dhe jemi në kontakt me ta del se nuk ka një ndihmë nga komuna ashtu siç po deklaroheni ju.Prandaj kërkojmë një angazhim tjetër dhe një mundësi qe me ju tregu qytatarëve që

ekzekutivi është përkrah tyre. Ne mujna me marrë si vendim tani ndërsa ne buxhetin e vitit të ardhshëm me propozu si vendim mos t'i këputim krejt shpresat për qytatarët.

Imri Ahmeti, nuk është mirë me thanë le të mirren vendimet për vitet e ardhshme, pasi që unë jam përgjegjës për menaxhimin e buxhetit para publikut dhe kur ka pas ide të mira unë i kam pranë ato ide nga ana juaj. Kushdo prej qytatarëve që ka nevojë për ndihmë le të lajmohet në shtabin e komunës cilado familje qoftë.

Lulzim Rrustemi, kryetari i merr vendimet në bazë të kompetencave të veta por edhe kuvendi i merr vendimet e veta dhe ky propozim ju ka parashtrë kuvednit e nëse kuvendi merr vendim ti duhet me zbatu.

Imri Ahmeti, nuk ka ligj as dipsozitë ligjore që nuk e ngarkon kryetarin e komunës për vendimet e kuvendit. Zyrtari kryesor administrativ i kuvendit të komunës është kryetari dhe nuk guxon kryetari i komunës me imponim vendime që janë jashtë ligjit. Unë ju tregova që skemi qysh me marrë një vendim të tillë dhe nuk po du me mashtrë publikun me diçka që nuk bëhet.

Daut Azemi tha se propozim të cilin e dha anëtarja e kuvendit është pa bazuar dhe i pa arsyetuar mirë, unë e qes rendin e ditës ashtu siç e lexova në fillim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim Rrendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për 7 kundër dhe apstenim kalon rendi i ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Manush Shamolli, kam një shqetësim të banorëve të fshatit Shalë rreth rrugicave, ku nuk janë shtruar rrugicat të cilat janë në kadastër por janë shtruar rrugicat private, psh rrugica të sheshi "Rambuže", është rrugë publike dhe nuk është shtruar po ashtu edhe një rrugicë tjetër në fillim të fshatit e cila nuk është shtruar e ky është shqetësim i imi dhe i shaljanëve.

Shkelzen Bislimi, e kam pas një pyetje rreth personave të prekur me Covid-19 a kemi mundësi me e bo një pagesë, por po e shoh që nuk kemi mundësi me bo pagesë sipas kryetarit. Shuajtja për mësimdhënës e paraparë sipas kontratës kolektive a do të paguhet. Edhe kërkoj një informatë rreth parkingut të feronikëlit a është privatë apo publike pasi që disa persona po detyrohen të paguajnë parking.

Ramiz Qeriqi, se pari ju falenderoj për këto qantat që na i dhurët. I kam disa shqetësime të qytatarëve e para ka të bëjë me ndarjen e bursave për studentë ku ka vërejtje nga disa studentë. E dyta rreth një konkursi për praktikant pse është anuluar. Ka në shqetësim të banorëve të lagjes ku unë banoj mbrapa ABE-s a do të ketë ndodhje vendkalim të hekurudha.

Imri Ahmeti kryetari i komunës, tha se Manushi ka të drejtë por unë nuk kam vendosë se cilat rrugë duhet me u shtruar por ka vendosë kryesia e fshatit emrat e rrugëve se cilat duhet të asfaltohen. Por ne duhet me gjetë mundësinë me i shtruar edhe ato rrugë të cilat kanë mbetur. Na po kemi telashe me problemet pronësore edhe në Shalë edhe në fshatrat tjera.

Sipas buxhetit nuk ka mjete jo sipas kryetarit. Shujtjet e arsimit janë problem jo vetëm në komunën tonë por edhe në shumë komuna, por komunat nuk janë palë nëshkruese të marrëveshjes kolektive. E ka nëshkruar ministria dhe për pasojë komunat nuk ka mjete me bo asnjë pagesë. Na kemi pas dëshirë me i pagu nga rezervat që i patëm e mos me i lanë me na paditë por nuk na është lejuar dhe ky është një problem që nuk ka zgjidhje në asnjë komunë të Kosovës. Shujtja nuk ju takon të gjithë personeli arsimor e as rruga nuk ju takon të gjithë personelit arsimor ju takon atyre që e kanë një distancë nga shkolla. Ne jave e ardhshme kemi një takim me ministrin për një zgjidhje për këtë qështje.

Parkingu të Feronikës nuk është, por të siguroj që do ta nxjerrim fletën poseduese dhe do të ju njoftoj për këtë temë.

Të bursat e studentëve unë kam kërkuar që çdo kriter të respektohet dhe ato janë publike, ata studentë të cilët i kanë meritë bursat i kanë marrë. Sivjet është rritë numri i bursave por duhet vitin e ardhshme me rishiku rregulloren për bursa. Studentët me notë të mirë kanë marrë bursa në fakultet.

Me praktikantën, ka qenë një marveshje me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ku ministria e paguan ne vetëm ju kemi gjet vendin ku do ta mbajnë prkatikën janë 27 praktikantë.

Te hekurudha do të bëhen dy vendkalime ku kemi arritur një marrëveshje me hekurudhën njëri te Golden Day e tjetri te Viva.

Alban Salihu,ditëve të fundit ka pas reagime nga banorët e fshatit prej nga vi une,rreth mënyrës së përzgjedhjes së asfaltimit të rrugicave, ku po asfaltohen rrugica familjare me 1 apo dy shtëpi ndërsa mbesin lagje me 60 e më shumë shtëpi pa u asfaltuar.Ju lus që të përdorni kriteret e mos të bëni diskriminime të tilla.

Bashkim Budakova,kam një pyetje për drejtoratin e arsimit sa është numri i të infektuarve të mësimdhënësve me Covid-19 dhe a janë zëvdënsuar dhe si janë zëvendësuar ato orë të humbura.Pyetja e dytë është cila është arsyeja e ndërrimit të shtyllave paraprake me këto të reja në rrugën katër korsi në Lipjan.

Lumturije Bytyqi-Hasani,fillimisht propozimi i është dërgu kuvendit dhe juve si kryesues,vlerësimin e bënë vetëm kuvendi dhe askush tjetër,kuvendi e bën këtë përmes votës dhe ti me këtë bënë shkelje ligjore.

Mirë do të ishte që edhe rrugicat tjera të asfaltohen në Shalë pasi që ky projekt e kishte ndryshu Shalën pasi ishin shtrur shumica e rrugëve në Shalë por shpresojmë që edhe ato pak rrugica që kanë mbet të përfundohen.

Para disa dite është raportuar në media se një pronar e një parcele në Rubofc ka deklaruar se komuna nuk ka pas pelqim paraprak për asfaltimin e asaj rruge si ka ndodhë kjo? Po ashtu në atë storie u raportua se edhe stadiumi në Babush është në pronë të AKP-s,sa qendrojnë këto pretendime.

Daut Azemi,tha sa kryetari e dha arsyetimin dhe une jam ai i cili vendosi a duhet me qit në kuvend porpozimin apo jo.Dhe në nenin 2 te arsyetimi e ke shënuar që planifikimi të bëhet për vitin 2020 e dihet që aty ska mjete sepse po përfundon viti.

Lulzim Rrustemi,kam një pyetje për drejtorinë e kulturës për subvencionet për OJQ ku e kam pa një njoftim që ka përfitu vetën një organizatë YAHR në vlerë prej 10 mij euro dhe nuk ka organizata tjera.A ka pasë organizata tjera që kanë aplikuar apo vetëm kjo.E dyta te lumi janjevka qe është tu punu e kam pa që pusetat e kanalizimit janë të mbyllura me dhe e me gur dhe nëse tash nuk intervenohet kemi me pas telashe gjatë dimrit.

E ndaj shqetësimin e banorëve të Shalës,Banullës dhe fshatrave tjera,ku e kemi cek disa herë në kuvend që rrugët duhet të jenë të emërtuara dhe gjatë hartimit të projekteve të radhiten sipas planit strategjik dhe sipas nevojës qytatare dhe duke i radhitë rrugët a janë private apo publike.

Prej nga vendimi që mos të dekorohet sheshi për festat e fund vitit,e kam pa një anketë në Facebook por dekorimi i qytetit është dashtë të bëhet.Pasi qe ne duhet me ju dhanë qytatarëve shpresë për ditë ma të mira.

Imri Ahmeti kryetari i komunës,në pamundësi që me u adresu të gjitha kërkesat nuk po kemi mundësi të gjitha kërkesat me i realizu,pasi që nuk po ka mundësi në të njejtin fshat të gjitha rrugët me u shtrur për një herë dhe kjo po ndodhë në të gjitha fshatrat.Shtyllat në rrugën katër korsi në Lipjan po ndërrohen pasi që shumica e tyre kanë filluar të demolohen e disa janë rrëzu dhe kanë pas edhe shpenzime të mëdha.Ndërsa tash Lipjani ka ndriçim të ri dhe do ta mbulojnë vetveten.Për stadiumin në Babush nuk e di a është në pronën e AKP-s,por shkolla e di qe është në pronën e AKP-s dhe janë bërë kërkesa që 15 vite që ajo pronë me u bartë në emër të komunës.Përgjegjjet e AKP-s kanë qenë qe na ua epim atë pronë vetëm ku po na epni ju ne vend të saj.OJQ,kanë apliku me projektet e tyre por Lipjani ka hy në zonën e kuqe nuk mund të zhvillohen aktivitet për shkak të situatës në të cilën gjindemi.OJQ nuk mund me zhvillu aktivitet kur Lipjani është në zonën e kuqe dhe mua me ka detyru me ndalu atë tender.Ndërsa ju që përmendet është aplikuese në planin e veprimit rinor 2020-2021

Vendimin për dekorim të qytetit e kam marrë vendimin në bazë të vullentit të qytatarëve,mjetet nuk humbin.Nuk do të ket dekorim të sheshit.

Alban Salihu,unë besoj që është dashtë me u marrë një vendim i njëjtë nga të gjitha komunat për dekorimin e qytetit. Ndërsa është e padrejtë me u asfaltu një rrugicë ku është vetëm një familje ndërsa të jetë lagja tjetër me 60 shtëpi pa u asfaltuar.

Ramiz Qeriqi,kisha kërku qe të lapidari i Adem Jasharit të vendoset ndonjë flamur sepse nuk është aty i vendosur asnjë flamur.Sa i përket rrugicave nëse nuk janë shtru tani, do të shtrohen ma vonë,por është mirë që ata që po shtrohen të jenë kualitet dhe me të gjëra.

Albulena Kelmendi,së pari ju uroj të gjithë atyre që e kanë kalu Covidin e që ka edhe prej atyre që janë prezent këtu.Në fillim të pandemisë komuna e Lipjanit ka qenë shembull për të mirë sa i përket reseptimit të masava, ndërsa tani për fat të keq jemi në radhitjen e komunave të para me te prekurit me Covid-19. Unë prita debat ma të madh sa i përket covidit. Kam pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë rreth furnizimit me barna a është duke u furnizu QKMF-ja me barna esenciale. Pasi që qytetarët po përballen me kosto të jashtzakonshme për sigurimin e barnave për Covid-19,analizat janë shumë të shtrejtta.Po ashtu pse analiza CRP nuk bëhet ne QKMF.Pyetja tjetër ka të bëjë me zëvendësimin e personelit arsimor ku janë duke u humbur orë për arsye se profesorët po infketohen me Covid dhe nuk po ka kush me i zëvendësu.

Një rrugë nuk më kujtohet me emër te komuna e re me dale ka ambulanta duke shku ka QKMF-ja Ee cila është në gjendje të keqe.Pediatrit ka filluar punën në QKMF.

Argjend Tasholli,i kam disa pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike,e para ka të bëjë me problemin e kanalizimit në Gadime dhe fshatra tjera ku janë mbyllur kanalizimet dhe gypi kryesor i kanalizimit në Gadime derdhet nëpër lum.Po ashtu është bër një peticion nga banorët e Gadimes për hapjen e një rruge te lagja Tasholli te xhamia. Rruga “Bajram Gajtani” në janjevë është vështirë të kalohet për shkak të baltës.Edhe në fshatin Smallushë është një shqetësim i banorëve pasi qe janë vendosur mbrojtëset në rrugë dhe prap janë hiç pse nuk po përfundon ky trotuar.

Hyra Bytyçi,se pari e falenderoj drejtoreshën për përgjegjësinë që çdo herë kujdeset ndaj qytetarëve lidhur me informatat për covid 19.Vetëm kam një shqetësim se sa janë reale këto raste.Po ashtu sa ka koordinim Instituti i Shëndetit Publik me ordinancat private për shkak se qetu mujna me pas një situatë jo reale.

Nëse eskalon situata e keni ndonjë plan B,ndonjë plan emergjent.

Te ndriçimi qe po bëhet në rrugën Lipjan-Magure,ku është bërë një punë shumë e mirë qe e falenderoj kryetarin,por a do të vazhdoj ndriçimi edhe në rrugën Qylagë-Dobrajë.

Afrim Miftari,kam një kërkesë të qytatarëve të Gadimes ku në ambulancën e Gadimes marrin infuzione në një dhomë edhe ata me virusin sezonal apo me sëmundje tjera por aty marrin edhe përsinat qe janë të prekur me covid dhe ata shqetësohen se kjo mund të jetë një vatrë e infeksionit, e frika ma e madhë është kur kanë me i dërgu fëmijët e tyre.A eksiston mundësi që të bëhet një investim aty në një dhomë e cila gjindet aty, por vetëm ka nevojë për ngjyrosje dhe disa shtretër dhe të jetë vetëm për përsinat me Covid-19

Te varezat në Gadime po punojke një kompani po bënte pastrimin e varrezave dhe aty po u bëhet një punë shumë e mirë,ju përgëzoj dhe ju falënderoj.

Arben Salihu,kam një kërkesë të qytatarëve të fshatin Hallaq i Vogël,qe të vendoset një pengesë në rrugën Lipjan-Mgaure, te shkolla e fshatit pasi që po zhvillohet një shpejtësi e madhe ose të paktën të ket frekuentim më të madh të policisë.

Imri Ahmeti,aty është rrugë regjionale dhe ne është veshtirë me marrë përgjegjësi edhe pse ka nevojë të ketë pengesa në atë rrugë.

Mirëmbajtja e varrezave është projekt dy vjeçar dhe të gjitha varrezat dhe labidarët në komunën tonë do të mirëmbahen dy herë në vit. Në Gadime shumë shpejtë do të filloj qerdhja.Për QMF-n në Gadime nuk e di por shumë shpejt do të vin shtretërit e ri, të shohim nëse do të ket nevojë edhe atje në Gadime do t'i qojmë disa. Ndriçimi Lipjan-Mgurë do të shkon deri në Vrellë. Ndërsa rruga Qylagë Dobrajë nuk do të keq ndriçim.Edhe unë e kam prit që ma shumë sot do të diskutojmë për Covidin. Na kemi problem me arsim zevendesim

peronelit arsimor, ku parafshihet për një zëvendësim 3 muaj për procedurë që është absurde. Aktiv me covid-19 nga personeli arsimor i kemi aktiv 9 tani, nga 27 që kanë qenë pozitiv nga 281 të testuar. Zëvendësimet kanë ndodhë me vullnetar dhe asnjëri nga ata nuk ka kontratë dhe mirë që kemi vullnetar në Arsim dhe Shëndetësi dhe kudo që kemi nevojë.

Merita Bytyqi, unë jam e përgaditur nga fillimi dhe e përcjelli gjendjen në shëndetësi dhe Qendrën për punë sociale. Furnizimi me barna esenciale në QKMF asnjëherë nuk ka qenë me i lartë. Analizat CPR nuk bëhet te ne sepse nuk është me udhëzim administrativ. Pediatri është kthyer në gjysmë të tetorit por nuk kemi pediatri dhe dytë edhe pse e kemi shpallur konkursin por nuk është lajmruar askush. Unë bazohem vetëm në shifrat e institutit. Na jemi të përgatitur në bazë të rrjedhës së rasteve. Na i kemi aktualisht 12 shtreter dhe do të jenë edhe 16 shtretër të ri por do t'i ftojme edhe stafin tjetër shëndetësor për ndihmë siç janë stamatologët e të tjerë. Në Gadime kam qenë e kam disa herë aty edhe e kam vizitë, dhe e kemi planifikim edhe furnizimin me shtretër.

Ukë Kryeziu, unë i falenderoj dhe shprehi mirënjohje për mbështetjen morale që më ka dhënë kryetari, kryesuesi drejtori dhe të gjithë ata që kanë qenë të njoftuar për periudhën Covid të cilën tani e kam kaluar. Kam kërkesë për drejtoreshën e shëndetësisë, që të bëhen testet Rapid për covid-19. Në fund të gjithë të sëmuarve ju uroj shëndet ndërsa atyre që kanë humbur familjarët e tyre ju shprehu ngushllime.

Daut Azemi, për ata që kemi pas informacion që janë të prekur me Covid-19 të pakten një telefonatë ju kam bërë për t'i pyetur për gjendjen e tyre, kërkoj falje nëse dikë nuk e kam thirrë, sepse e kemi obligim në situata të tilla me qenë të gjithë së bashku.

Pastaj u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 38-të të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 38-të të Kuvendit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për

Aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 38-të të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Popozim vendim për miratimin e Planit të Integritetit 2021-2022

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Ollurit, drejtor i Administratës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Meqë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi e vuri në votim raportin vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 23 vota për, aprovoi këtë.

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT 2021-2022

Neni 1

MIRATOHET, Plani i Integritetit 2021-2022 i Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i Integritetit 2021-2022.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Administratë.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

III

Prezantimi i Raportit të Punës të Sektorit për Personel Janar-Nëntor 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Olluri, drejtor i Adminsitratës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti,

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rusetmi,kish disa gabime teknike raporti,është mirë qe te zyra e personelit kur ti shpallen konkurset per shkak të transaprencës vlersimet të bëhen me pikë dhe kur të del fituesi te dalin edhe pikët e fituara.Dhe kjo do te ishe me transaprente,dhe ne e përkrahim.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati u kalua ne pikën në vazhdim

IV

Propozim vendimi për shpalljen e lokalitetit të Boshtres(Forsythia Europea) Golesh si zonë e mbrojtur.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU-së,i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shklezen Bislimi,mirë qe u hy kjo bimë por ka edhe bimë tjera qe duhet me hy në mbrojtje.Une deshta me falenderu ekzekutivin për punën qe e ka bo në pastrimin e varrezave në Gadime.

Afrim Miftari,kjo bimë e cila gjindët në këtë hapsirë prej 32 hektar është në Komunën e Lipjanit por i përfshinë edhe 2 komuna tjera.Mirë qe ky komision ka dhënë një vlersim profesional.Në komunën e Fush Kosovës zhvillohen disa veprimtari siç është një lloj qymyri i cili përdoret për nxemje, e është mirë qe të kërkohet nga kryetari i Fush Kosovës qe të pakten mos te ju lejohen zhgjerimi i asaj veprimtarie.

Hyra Bytyçi,ne si grup i LDK-s jemi pro këtij propozim vendimi,ne jemi krenar qe edhe në zonën tonë e cila është shëruese edhe e kërkuar edhe në tregun botror.

Emina Rexhiq,kjo bimë është e vtmja për momentin,komuna tjera i kam kry këtë vendim ka mbet vetëm komuna e jonë.

Meqë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim rregullore dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 2 votat për aprovoi këtë:

VENDIM

PËR SHPALLJEN E LOKALITETIT TË BOSHTRËS (FORSYTHIA EUROPEA) GOLESH SI ZONË E MBROJTUR

Neni 1

MIRATOHET, Vendimi për shpalljen e lokalitetit të Boshtres “Forsythia Europea” –Golesh si zonë e mbrojtur në kategorinë e monumentit të natyrës.

Neni 2

Zona e mbrojtur si monument i natyrës që e përfshinë territorin e Komunës së Lipjanit është në sipërfaqe prej prej 33.2 Ha.

Boshtra “ Forsythia Europea” kategorizohet në kategorinë e monumentit të mbrojtur të natyrës për ruajtjen e arealit të kësaj bime të rrallë.

Neni 3

Sipërfaqja e zonës së mbrojtur e evidentuar në nenin 2 të vendimit të cilës i caktohen dhe vendosen kufijtë për territorin e mbrojtur përfshin lokacionin cili shtrihet në parcelat kadastrale: P-71409016-00213-0 ZK Vrellë –Pronë e Kuvendit Komunal, Parcela P-71409016-00214-0 ZK Vrellë –Pronë Private Zeka Topalli, Parcela P-71409016-00215-0 ZK Vrellë – Pronë Private Sylejman Topalli, Bekim Topalli, Agim Topalli, Parcela P-71409016-00217-0 ZK Vrellë – Pronë Private -Syl Kelmendi, Parcela P-71409016-00215-0 ZK Vrellë – Pronë Private -Islam Topalli , Parcela P-71409016-00219-0 ZK Vrellë – Pronë Private –Ismet Dugolli, Parcela P-71409016-00220-1 ZK Vrellë – Pronë Shoqërore Seksioneve të pylltarisë

Neni 4

Masat për mbrojtje që duhet të ndërmerren konform legjislacionit në fuqi në zonën e cekur janë:

- 1.1 Mos ndërtimi i objekteve të pa planifikuara,
- 1.2 Vazhdimi i hulumtimeve të mëtejme të vlerave natyrore,
- 1.3 Ndalimi i hedhjes së mbeturinave.
- 1.4 Ndalimi i prerjes së drunjëve pa leje të posaçme të Sektorit të pylltarisë.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen, Drejtorati për Planifikim,Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 6

Ky vendim pas hyrjes në fuqi, duhet të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe Institutit Kombëtar për Mbrojtjen e Monumenteve me qëllim të regjistrimit në Regjistrin e vlerave të mbrojtura të natyrës.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim vendimi paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit, drejtor i DEZH-së,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, është mirë që këto lokale me u shfrytzu mos me mbet pa u shfrytzu,ku gjenden këto lokale.Ne si grup i PDK-s e përkrahim këtë propozim.

Bekim Shabani,nuk ka pas interesim na partitë politike për ti marr këto lokale.Njëra gjindet ish gjelltorja Korabi ndërsa dy tjera te selia e PDK-s

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 24 votat për aprovoi këtë:

VENDIM
PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim u ipen në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik paluejtshmëritë-lokalet afariste në pronësi të komunës, të cilat gjenden në qytetin e Lipjanit - Zona kadastrale në Lipjan, me shënimet si në tabelën në vijim:

Nr	Njësia kadastrale	Adresa	Kati	Numri i lokalit	Sipërfaqja në m ²
1	0-71409044-01926-0-29-1-17-0	Rruga "Lidhja e Prizrenit"	Bodrum	6	81.35m ²
2	01930/1, 01187/1,01923/0	Rruga "Lidhja e Prizrenit"	Përdhesë	15	159 m ²
3.	01930/1, 01187/1,01923/0	Rruga "Lidhja e Prizrenit"	Bodrum		239 m ²

Neni 2

Pronat e paluajtshme –lokalet të cekura në pjesën tabelare në nenin 1 të këtij Vendimi ipen në shfrytëzim, afatshkurtër në afat prej 10 vitesh nëpërmjet procedurave të ankandit publik të përcaktuar me dispozitat e të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme-lokaleve në pronësi të Komunës të cekura më lartë bëhet me qëllim të realizimit të interesit publik përkatësisht krijimin e të hyrave vetanake dhe rritjen e vlerës së pronës publike komunale me destinim për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të biznesit .

Neni 4

Procedurën e ankandit publik e zbaton Komisioni Vlerësues në pajtim me dispozitat e Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës .

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Ekonomi e Zhvillim dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi

1. Shfuqizohet Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-20393 i datës 29.03.2019,
2. Te Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-28074 i datës 02.05.2018 në nenin 1 hiqet-fshihet lokali në numrin rendor 3 ,
3. Te Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-6525 i datës 01.02.2018 në nenin 1 -fshihet paragrafi 1.3.

Shtesë:Vendimi.

VI

Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit, drejtor i DEZH-së,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pasatj Kryesuesi e hapi diskutimin:

Nehat Tërpeza,ne si grup i LDK-s për anëtar të komisionit e propozojmë Majlinda Sylejmanin.

Argjend Tasholli,ne si grup i PDK-s e propozojna Zazmi Krasniqin për anëtar të Komisionit.

Daut Azemi tha po e hudhi në votim përbërjen e komisionit:

- 1.Bekim Shabani Kryesues nga Eksektutivi,
- 2.Nazim Gashi,anëtar nga Eksektutivi,
- 3.Majlinda Sylejmani nga subjektet politike
- 4.Nazmi Krasniqi,nga subjektet politike
- 5.Densi Gashi nga OJQ

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 22 vota për aprovoi këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK LIPJAN

Neni 1

Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronave së paluajtshme të komunës– lokaleve afariste për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr._____ i datës _____ (në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Bekim Shabani, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim nga ekzekutivi i Komunës
- 2.Nazim Gashi, Drejtor i Drejtoratit për Mbrojtje dhe Shpëtim nga ekzekutivi i Komunës
- 3.Majlinda Sylejmani,nga subjektet politike
- 4.Nazmi Krasniqi, nga subjektet politike
5. Denis Gashi nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2

Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3

Mandati i anëtarëve

Manadati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës _____ të datës _____ .

Neni 4

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nëligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor-juridik.

Neni 6

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pasatj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 24 vota për aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2021

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi i Komunës së Lipjanit **cakton** normat tatimore për

vitin 2021 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për njësiti bujqësore të parcelave----- 0.15 %
- Për njësiti bujqësore të objekteve----- 0.15 %
- Për njësiti pyjore të parcelave----- 0.15 %
- Për njësiti rezidenciale të parcelave----- 0.15 %
- Për njësiti rezidenciale të objekteve----- 0.15 %
- Për njësiti komerciale të parcelave----- 0.30 %
- Për njësiti komerciale të objekteve----- 0.30 %
- Për njësiti industriale të parcelave----- 0.20 %
- Për njësiti industriale të objekteve----- 0.20 %

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa –Sektori për Tatim në Pronë.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës dhe fillon të zbatohet nga 1 janari 2021.

VIII

Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shefqet Amerllahi drejtor i Bujqësisë-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pasatj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, a është duke u impelmentu në teren ky projekt edhe a është vetëm për këtë vit apo edhe për vitet tjera.

Shefqet Amërlahu, po është duke u implemtuar në teren dhe ky projekt është 3 vjeçar

Meqë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 26 vota për aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **7,800.00 €** (shtatë mijë e tetëqind euro), për kryerjen e obligimeve që rrjedhin konform dispozitave të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës- IADK 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020 për zbatimin e Projektit **“Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës** i financuar nga Donatori BfdW nga Gjermania dhe zbatuar nga IADK që shtrihet në komunat Vushtrri, Skenderaj, Lipjan, Shtime, Viti dhe Kamenicë.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet konform dispozitave të nenit 3 të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK, 1Nr. 320-16457 të datës

18.03.2020 në të cilën përcaktohet që Komuna e Lipjanit do të participojë me 20% të bashkëfinancimit për përfituesit e përzgjedhur dhe mbështetur.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës- kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural .

IV.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Shtesë: Vendimi.

IX

Propozim vendim për miratimin e Planit Orientues të Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2021.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi i planit të punës së kuvendit.

Pasatj Kryesuesi e hapi diskutimin

Lulzim Rusetmi,kam një propozim qe për muajin janar të jetë një informatë nga drejtorati për shëndetësi,rreth Pademisë Covid-19 në komunën e Lipjanit.

Pasatj Kryesuesi e hudhi ne votim propozimin e Antarit te kuvendit dhe me 26 vota per kaloi kry propozim.

Meqë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 26 vota për aprovoi këtë

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT ORIENTUES TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2021

Neni 1

MIRATOHET Plani orientues i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2021.

Neni 2

Kuvendi i Komunës së Lipjanit planifikon ti mbajë 12 mbledhje të rregullta dhe secilës mbledhje të rregullt i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 3

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të mbahen sipas periodës kohore me rendin e ditës sipas tabelës në vijim:

JANAR 2021	Informatë e Kryetarit mbi Planin e Punës së Ekzekutiv për vitin 2021
	Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare të Komunës për periudhën Korrik – Dhjetor 2020
	Miratimi i Planit Vjetor të punës së Këshillit Komunal për Sigurinë Bashkësi (KKSB)
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë nga Drejtorati për Shëndetësi rreth situatës me pandeminë covid-19
SHKURT 2021	Bartja (rialokimi) i buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak
	Informatë mbipërfundimin e gjysmëvjetorit të parë shkollor
MARS 2021	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës për vitin 2020
PRILL 2021	Shqyrtimi i informatës të rezultateve financiare të Komunës për periudhën Janar – Mars 2021
	Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
Maj 2021	Informatë mbi Qarkoren e pare buxhetore të MF-se
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbipunën e komiteteve funksionale
QERSHOR 2020	Miratimi i Korrnizës Afatmesme Buxhetore 2022-2024
	Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2021
	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbirealizimin e Planit të Prokurimit
KORRIK 2021	Shqyrtimi i informatës financiare të Komunës për periudhën Mars – Qershor 2021
	Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2020
	Informatë mbi Raportin e Performancës
	Informatë mbipërfundimin e vitit shkollor
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
GUSHT 2021	Informatë mbipërfundimin e fushatës së korrje-shirjeve
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi Qarkoren e dytë buxhetore të MF-se
SHTATOR 2021	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2022
	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022
	Informatë mbifillimin e vitit të rishkollor
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë
	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksa komunale
TETOR 2021	Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës për periudhën Korrik – Shtator 2021
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
OR202	Informatë e Drejtoratit për Shëndetësi dhe përkujdesje sociale për ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore

Neni 4

4.1 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vet, të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave tjera ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit mban së paku dhjetë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.2 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe më shumë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.3 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne në rastet e caktuara me dispozitat e cekura ligjore.

Neni 5

Plani i mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si në nenin 3 të këtij Vendimi është orientues dhe do të mund të ketë ndryshime gjatë vitit.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 12,³⁵

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi